



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.139/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje - LVV, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 24.01.2025, merr këtë :

VE N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa Anr.139/2025 e datës 23.01.2025, të parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje - LVV, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datën 23.01.2025 PZAP-i, ka pranuar permese postes një ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se më datë 19.01.2025, kandidati për kryeministër nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti në tubimin e mbajtur në sallën e sporteve "Bill Clinton", në Ferizaj, në mes tjerash shprehet me gjuhë denigruese, urrejtëse: "dhe sepse PDK, LDK.....LDK, PDK nuk janë ndryshimi por janë ndryshku i cili maroj dhe shkoj...", përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34, pika 1.11 të LZP-së. Tutje në ankesë është kërkuar nga PZAP-ja që të miratojë ankesën e degës së Partisë Demokratike të Kosovës në Ferizaj, në mënyrë që të respektohen rregullat e fushatës zgjedhore duke shmangur përdorimin e gjuhës, fyese, denigruese dhe urrejtëse.

Si provë në ankesë ka bashkangjitur video inqizimi në CD dhe linkun në facebook:<https://www.facebook.com/share/v/15gkRa1Y7G/>

Më datë 23.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës për ankesën e parashtruar kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë 24.01.2025, në ora 10:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 24.01.2025, të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje - LVV e kundërshtojnë në tërësi ankesën e parashtruar nga PDK, në të cilën ka theksuar se ankesa është e pasafatshme, meqë tubimi ka ndodhur me datë 19 janar 2025 dhe ankesa është dorëzuar në PZAP nga parashtruesi më 23 janar, konsiderojmë që ankesa është e pasafatshme për shkakun se nuk është paraqitur brenda 48 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar brenda dyzet e tetë orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, siç parashihet me dispozitat përkatëse të LZP-së. Pra parashtruesi jashtë afatit ligjor ka parashtruar ankesë ndaj një tubimi që ka ndodhur me 19 janar 2025, siç edhe paraqitet në ankesë dhe për raste të njëjta PZAP tashmë ka praktikë të vendosur përmes vendimit Anr.80/2025 të datës 22 janar 2025, me anë të të cilit ankesat Anr80/2025, Anr 81/2025 dhe Anr.82/2025, i ka hedhur si të pasafatshme dhe i ka propozuar që të hedhet e pasafatshme ankesa Anr.139/2025 e palës parashtruese, kundër Lëvizjes Vetëvendosje.

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së ankesës, gjeti se:

-Ankesa është e pasafatshme.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 39 paragrafi 3 i LZP-së, i cili përcakton se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqes ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i, do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimit të saj, si dhe neni 13, paragrafi 3, nen paragrafi 3.3 i Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, i cili përcakton se “PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim, nën paragrafi 3.3. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor.*

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën në poste më datë 23.01.2025, kjo vërtetohet përmes vulës së pranimit në poste dhe të njëjtën ditë ankesa është pranuar edhe në PZAP, ndërsa shkelja e pretenduar sipas ankesës ka ndodhur me datë 19.01.2025 gjatë tubimit elektorale të mbajtur nga LVV në qytetin e Ferizajit.

Mirëpo, ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 39, paragrafi 3 i LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesës është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

Andaj Paneli gjeti se i njëjti është ushtruar pas afatit ligjor, dhe nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 39 paragrafi 3, nenit 115 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.5 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.139/2025 më datën 24.01.2025

Kryesuese e Panelit

Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.